



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

AD.GJTHM.nr.03/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur ne çështjen disiplinore te ngritur ndaj I.G, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovice-Dega në Vushtrri-Divizioni civil, duke vepruar sipas ankesës disiplinore te parashtruar nga pala F.A nga Vushtrria, pas vlerësimit te ankesës së parashtruar nga pala dhe pranimit te deklaratës se Gjyqtarit I.G i dt.23.03.2023, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me date 18.04.2023, merre ketë;

A K T V E N D I M

REFUZOHET Ankesa disiplinore e dt.24.03.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.03/2022, e parashtruar nga pala F.A, nga Komuna e Vushtrrise, kundër Gjyqtarit I.G, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovice –Dega në Vushtrri-Divizioni civil, e **PA BAZUAR**.

A r s y e t i m i

Në cilësinë e Nënkryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me dt.24.03.2023, kam pranuar parashtrësën e parashtruar nga palës F.A nga Vushtrria, kundër Gjyqtarit I.G, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovice –Dega në Vushtrri-Divizioni civil.

Në Gjykatën Themelore Mitrovice –Dega në Vushtrri është duke u zhvilluar procedura përmbartimore në çështjen juridike të Kreditorëve E.A, L.A dhe E.A të cilët i përfaqëson përfaqësuesja e tyre ligjore L.H kundër debitorit F.A lidhur me pagesën e alimentacionit.

Përfaqësuesja ligjore e kreditorëve me dt. 09.03.2023 përmes parashtrësës e ka njoftuar gjykatës se debitori F.A nuk është duke e respektuar aktgjykimin C.nr.382/15 të dt.18.01.2016 lidhur me alimentacionin për fëmijët e mitur.

Gjykata në pajtimin me paragrafin 5 të nenit 15 të LPP, ka kërkuar nga debitori që na aftin prej pesë ditëve të deklarohet lidhur me arsyet e mos zbatimit të aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.382/15 të dt.18.01.2016, nën kërcënimin e ndërmarrjes së veprimeve tjera ligjore.

Në Përgjigjen e kërkesës së Gjykatës për deklarimit të dt.22.03.2023 pala F.A ka njoftuar se prej viti 2015 është në procedurë lidhur me alimentacion sipas aktgjykimit C.nr.382/15 të dt.18.01.2016, ku ish bashkëshortja e tij ka iniciuar procedurë penale për mos zbatimit e aktgjykimit të formës së prerë dhe kjo lëndë është zhvilluar sipas aktakuzës PP.II.nr.348/17 të dt.23.05.2017, kjo aktakuzës ka përfunduar me aktgjykim lirues edhe përkundër faktit se ka përfunduar gjykimi dhe zyrtar të gjykatës kanë qenë në shtëpinë e tij me urdhër të gjykatës që të paguaj alimentacionin, i kam treguar në detaje se nuk kam mundësi të paguaj sepse jam i papunë dhe nuk kam kurrfarë të ardhurash dhe po të kisha mundësi financiare do të paguaj se ata janë

fëmijët e tij. Kërkon nga nënkryetari që të marre masa ndaj gjyqtarit të çështje dhe zyrtarit të gjykatës dhe ti dërgon në komision disiplinor për shkak të ndihet keq psikikisht për faktin se tani është i martuar me gruan e dytë dhe ka një fëmijë.

Subjekti i hetimit- Gjyqtari në deklaratën me shkrim lidhur me kërkesën e debitorit- F.A, i ka përshkruar në detaje veprimet e ndërmarra në lëndën CP.nr.75/21, duke theksuar se debitori për herë të parë në gjykatën e ka njoftuar gjyqtarin e çështjes dhe ka dorëzuar aktgjykimin penal P.nr.236/18 të dt.24.11.2021 i vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.8/21 të dt.09.02.2021. Çështja se debitori është ndier nën presion me rastin e daljes së zyrtarëve të gjykatës për përmbarim e çështjes, është çështje subjektive, por njëherit është edhe detyrë e gjykatës përmbarimin e dokumentit përmbarues. Faktin se debitori tani është liruar nga përgjegjësia penale, nuk nënkupton edhe lirim të tij nga përgjegjësia civile sepse dokumenti përmbarues (C.nr.382/15 të dt.18.01.2016) nuk është anuluar, ndryshuar apo shfuqizuar me vendim të formës së prerë. Nga të lartcekurat propozoj gjykatës që kërkesa e debitorit F.A ta hudhe si të palejuar apo ta refuzohet si të pabazuar sepse në të kundërtën gjyqtari apo personi i autorizuar gjyqësor do të viheshin në një pozitë që u pamundësoj kryerjen e detyrave respektivisht përmbarimin e vendimeve gjyqësore.

Në parashtresën e dt.22.03.2023, të cilën gjykata e ka vlerësuar ankesë, duke pasur mbështetje të nenit 5 par.3 të Rregullorës për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, debitori F.A ka ngritur çështjen lidhur me punën e gjyqtarit I.G. Kryetari i Gjykatës, duke pasur mbështetje të nenit 5 par.3 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, sipas të cilës çdo ankesë edhe në qofte se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë kur përmbajtja del se qëllim i palës është të praqes pretendim për shkeljet disiplinore nga ana e gjyqtarit.

Kryetari i Gjykatës në cilësinë e autoritetit kompetent sipas Ligjit për përgjegjësitë disiplinore për Gjyqtare dhe Prokuror, ka vlerësuar ankesën - deklaratën me shkrim të debitorit F.A dhe ka gjet se pretendimet janë në raport me gjyqtarin e çështjes dhe pakënaqësitë që i ka shprehur lidhur me punën e gjyqtarit të çështjes.

Autoriteti kompetent në rastin konkret gjen se nuk kemi shkelje disiplinore nga ana e Gjyqtarit I. G, pasi që i njëjti ashtu edhe siç e ka theksuar në deklaratën e tij po ashtu edhe në bazë të provave të cilat i ka analizuar autoriteti kompetent konstatohet se Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri ka marrë Aktgjykimin C.nr.382/15 të dt.18.01.2016 i cili është i plotfuqishëm sipas Aktgjykimit CA.nr.827/16 i dt.23.03.2016 dhe ka kjo vërtetohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me një aktgjykim i cili është marrë nga ana e Gjyqtarit në vitin 2016 ndërsa pala F. A për veprën penale Shmangie nga sigurimi i mjeteve të jetesës nga neni 252 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, është liruar nga përgjegjësia penale nga Gjykata Themelore Mitrovicë sipas Aktgjykimit P.nr.236/18 i dt.24.11.2020 i cili është vërtetuar sipas Aktvendimit PAM.nr.8/2021 i dt.09.02.2021, pra Aktgjykimi në çështjen penale është bërë i plotfuqishëm në vitin 2021 e që në rastin konkret Gjyqtari I.G ashtu edhe siç e ka theksuar në deklaratën e tij nuk ka qenë i njoftuar për këtë aktgjykim konkretisht pala këto aktgjykime nuk i ka dorëzuar në procedurën përmbarimore.

Pra në rastin konkret Gjyqtari I.G ka vepruar sipas Aktgjykimit C.nr.382/15 të dt.18.01.2016 i cili është i plotfuqishëm dhe i njëjti nuk është ndryshuar, anuluar apo shfuqizuar dhe se në këtë rast autoriteti kompetent gjen se nuk ka përgjegjësi disiplinore nga ana e gjyqtarit bazuar në Ligjin për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtar dhe prokuror apo në Rregulloren për procedurën disiplinore të gjyqtarëve.

Nga arsyet e theksuara me larte, ne mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinorë te gjyqtarëve dhe prokuroret dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 te Rregullore per Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
ADGJTHM.nr.03/2023, dt.18.04.2023

Nënkryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit F.A**
- 3. Gjyqtarit I.G**